



NGO NETWORK OF PEACE MOVEMENT –NOPM

**RAPORTI MONITORUES I
PERFORMANCËS SË EKZEKUTIVIT
TË KOMUNËS SË KAMENICËS**

**” PËRMIRËSIMI I QEVERISJES SË MIRË
PËRMES MONITORIMIT DHE
AVOKIMIT”**

PERIUDHA E RAPORTIMIT PRILL - DHJETOR 2014

Ky projekt është mbështetur dhe financuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) në kuadër të Programit të Granteve të Vogla te Komisionit për Demokraci



Hartuar dhe përgatitur nga: Besime Tusha dhe Sherafedin Vranja

Redaktuar nga: Sherafedin Vranja

Publikuar nga OJQ- Network of Peace Movement/Rrjeti i Lëvizjes Paqësore



Rr. Skënderbeu Nr# 28

62000 Kamenicë, Kosovë

Tel: +377 45 291 127

E-mail: ngo.nopm@gmail.com

JANAR 2015

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhja ekzekutive.....	3
Hyrje.....	4
Ekzekutivi i Komunës.....	6
Rreth organizatës jo-qeveritare – Rrjeti i Lëvizjes Paqësore.....	7
Transparenca dhe llogaridhënia.....	8
Respektimi i parimeve të transparencës dhe qeverisjes së mirë	9
Qasja në dokumentet zyrtare	10
Performanca buxhetore e komunës së Kamenicës.....	11
Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje dhe konsultimet publike.....	13
Instrumentet e demokracisë së drejtëpërdrejtë.....	13
Marrëdhëniet e Kryetarit me Asamblenë Komunale.....	14
Performanca e drejtorive komunale	15
Rekomandimet.....	16

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

OJQ Rrjeti i Lëvizjes Paqësore (NOPM) publikon raportin e monitorimit të ekzekutivit të Komunës së Kamenicës bazuar në monitorimin e punës së Komunës së Kamenicës gjatë periudhës Prill – Dhjetor 2014. Monitorimi është fokusuar në Ekzekutivin e Komunës, dhe përfshinë fushat: *transparencës dhe llogaridhënies, demokratizimit dhe qeverisjen e mirë*. Raporti ka për qëllim informimin e drejtë të institucioneve lokale, komunës, të qytetarëve, organizatave joqeveritare, dhe çdo grupi tjetër të interesit, për nivelin e funksionimit të organeve vendimmarrëse të komunës. Përmes këtij raporti synojmë të krijojmë një pasqyrë të qartë për qytetarët, lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre lokal. Gjithashtu, raporti shërben si një mjet adekuat për të rritur transparencën e organeve të pushtetit lokal. Ekzekutivi ri ka trashëguar projekte të pa përfunduara gjatë viteve të kaluara dhe më këtë edhe obligime të cilat ja kanë vështirësuar punën në menaxhimin sa më të mirë të parasë publike. Por, megjithatë ekzekutivi i Komunës së Kamenicës ka pasur disa lëvizje pozitive siç është zvogëlimi i shpenzimeve të derivateve të naftës, telefonisë mobile, dhe reduktimi i shpenzimeve administrative por ka pasur një rritje të shpenzimeve të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve të cilat janë rritur kryesisht me punësimin e mbi 20 punëtorëve me kontratë mbi vepër. Këto punësime i kanë kushtuar komunës mbi € 80,000 për një vit kalendarik. Po ashtu në këtë raport janë përfshirë të dhënat e përgjithshme të punës dhe aktiviteteve të organeve të ekzekutivit si dhe janë përfshirë gjetjet më të rëndësishme të evidentuara gjatë kësaj periudhe të monitorimit Prill - Dhjetor 2014. Raporti gjithashtu përmban analiza kualitative të legjislacionit në fuqi dhe praktikave më të mira mbi vetëqeverisjen lokale të cilat përdoren në lidhje me të gjeturat dhe përgjegjësitë e Komunës. Nga të gjeturat e monitorimit NOPM vlerëson se qeverisja në Komunën e Kamenicës gjatë periudhës Prill-Dhjetor 2014 është përballur me shumë vështirësi në realizimin e projekteve të planifikuara me buxhet për vitin 2014 si dhe formimi i institucioneve qendrore e që ka rezultuar në mos rishikim gjashtë-mujor të buxhetit, ka ndikuar negativisht në implementimin e projekteve kapitale. Në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies, që paraqesin dy prej shtyllave kryesore të funksionimit të institucioneve publike, Komuna e Kamenicës mbetet përgjithësisht e hapur për qytetarë dhe OJQ-të. Vlen të përmendet se ekzekutivi ka iniciuar ndryshimin e rregullores komunale për transparencë dhe planin e punës duke formuar grupin punues sipas legjislacionit në fuqi e cila është aprovuar nga kuvendi komunal si dhe ka ndarë fonde për OJQ ne vlere prej rreth €

15,000. Publikimi i këtij raporti përfshin monitorimin e punës së Ekzekutivit të Komunës dhe mbulon periudhën kohore prej Prill – Dhjetor 2014. Dhe krejt për fund vlerësojmë se informacionet e ofruara në këtë raport, e në veçanti gjetjet e paraqitura, do të shërbejnë në të mirë të proceseve të vetëqeverisjes lokale, të rrisin përgjegjësinë institucionale dhe komunës përkatësisht ekzekutivi që të ndërmarr hapa konkret në përmirësimin e veprimeve kundërligjore.

HYRJA

Gjatë periudhës së monitorimit Prill- Dhjetor 2014 nëpërmjet monitoruesve të saj nga afër ka përcjellë punën e ekzekutivit. Ky monitorim ka pasur për qëllim të identifikojë jo vetëm të metat eventuale të qeverisjes si dhe shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi por edhe të shënojë ngritjen e institucioneve si në aspektin e rritjes së kapaciteteve, shfrytëzimit të buxhetit dhe aplikimit të frymës demokratike të marrjes së vendimeve si dhe të komunikimit dhe të transparencës. Gjatë procesit të monitorimit NOPM ka synuar të rrisë besueshmërinë e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes por edhe të sigurojë një prani të përhershme të një mbikëqyrje transparente të funksionimit të pushteteve me theks të veçantë të transparencës në raport me qytetarin. Duke u nisur nga bindja se procesi i monitorimit është i domosdoshëm për këtë shkallë të zhvillimit të demokracisë sonë, derisa ende institucionet tona përballen me ngërçe institucionale dhe me mos-transparencë, NOPM konsideron se me punën e monitorimit është mundësuar një dobi e dyfishtë edhe në raport me institucionet por edhe me qytetarin. Institucionet komunale kanë pasur mundësi të dëgjojnë një zë jo kundërshtues apo refuzues arbitrar, por një zë këshillues dhe të sugjerimit për të avancuar proceset. Ndërkaq qytetari ka fituar një zë të sigurtë, një vlerësim bindës për zhvillimet brenda institucioneve komunale duke mësuar kështu më mirë se kah dhe ku harxhohet paraja publike, apo si janë caktuar prioritetet e projekteve. Gjatë punës së tij NOPM ka hasur bashkëpunime të hapura, të sinqerta, korrekt dhe transparente me kryetarin, stafin politik të kryetarit, drejtorët e drejtorive komunale dhe zyrtarët tjerë komunal prandaj për këtë i falënderon të gjithë ata që kanë ofruar të dhëna dhe sqarime në çdo moment, për ne shumë të nevojshme dhe të domosdoshme për të kryer misionin tonë prej monitoruesi. Vendimmarrja e cila prekë interesat e qytetarëve duhet të merret sa më afër tyre, këtë e siguron parimi i subsidiaritetit. Kjo u mundëson qytetarëve që të

përfitojnë shërbime publike më të mira dhe në mënyrë më efikase dhe transparente nga organet komunale.

QËLLIMET E MONITORIMIT TË PUNËS SË ZYRTARËVE KOMUNAL JANË:

- Që të sigurohet transparenca në punën e zyrtarëve të zgjedhur;
- Që të inkurajohen zyrtarët e zgjedhur në punën e tyre për gjetjen e zgjidhjeve që rëndojnë shoqërinë civile;
- Që të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në proceset politike vendim-marrëse ;
- Që të sigurohet kredibiliteti i proceseve politike;
- Që të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur ndaj qytetarëve dhe që ata të jenë përfaqësues të vërtetë të interesave të shoqërisë;
- Që të parandalohen parregullsitë e mundshme, aktivitetet mashtruese dhe kërcënimet;
- Që zyrtarëve të zgjedhur t'iu ofrohen informata mbi brengat e vërteta me të cilat ballafaqohet qytetari dhe shoqëria civile;

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Ekzekutivi i pushtetit lokal përbëhet nga dy organe: Zyra e Kryetarit të Komunës dhe nga Drejtorët e Drejtorive Komunale. Kryetari i komunës është udhëheqës i ekzekutivit të Komunës dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët e komunës me të drejtë vote. Ai ka mandat katërvjeçar, mandat të njëjtë me anëtarët e Kuvendit. Kryetari ushtron përgjegjësitë e përcaktuara nga neni 58 të ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Për të ushtruar përgjegjësitë e përcaktuara me ligj dhe përgjegjësitë e përcaktuara nga Kuvendi, kryetari ndihmohet nga nënkryetari i Komunës, Drejtorët e drejtorive dhe Administrata Komunale.

PROFILI I KRYETARIT - BEGZAD SINANI, KRYETARI I KOMUNËS



Është i lindur me 10.08.1963 në fshatin Kopernicë, Shkollën fillore dhe të mesme ka përfunduar –në Hogosht. Studimet Universitare – ecc i dipl, i ka përfunduar në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë dhe diplomon në temën “ Roli i politikës monetare – kreditore në mendimin ekonomik” . Krahas studimeve ishte edhe aktiv në jetën politike ku gjatë viteve të 90 udhëheq Forumin Rinor të Lidhjes Demokratike të Kosovës Dega ne Kamenicë si dhe dy mandate ka qenë anëtarë i Kryesisë së Degës së LDK- së. Pas luftës anëtarësohet në Partinë Demokratike të Kosovës të udhëhequr nga Z. Hashim Thaçi ku edhe sot vazhdon aktivitetin e tij në këtë parti. Në vitin 2000 punësohet në Shërbimin Civil Komunal, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike,(Referent për Çështje Ekonomike, e pastaj caktohet përgjegjës i saj). Nga elektorati dhe strukturat e degës së PDK-së zgjidhet Nënkyetar i Degës së PDK- së. Dy mandate është i zgjedhur delegatë në Kuvendin Komunal të Kamenicës dhe ku ka koordinuar punën e grupit të delegatëve të degës së PDK – së. Nga delegatet e Kuvendit Komunal zgjidhet Kryeshef i Ekzekutivit të cilët e kryen në një mandat te shkurtër 1 vjeçar deri në zgjedhje lokale të vitit 2007. Në zgjedhjet komunale të 17 nëntorit 2007 zgjidhet Kryetar i Komunës së Kamenicës me mandat dy-vjeçar 2007-2009. Kurse në zgjedhjet lokale të Nëntorit 2013 zgjidhet Kryetar i Komunës për here të dyte. Është i martuar dhe ka dy fëmijë.

FATMIR MATOSHI, NËNKRYETAR I KOMUNËS (AKR)

DRAGIŠA SAVIČ, NËNKRYETAR PËR KOMUNITETE (GISK)

Edhe pse sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, komuna nuk është obliguar për të emëruar nënkryetarin për komunitete sepse numri i komuniteti jo-shumicë

konsiderohet të mos jetë 10% sipas rezultateve të fundit të regjistrimit të popullsisë (2011), kryetari i komunës ka emëruara dhe kuvendi ka miratuar emërimin e tij kurse MAPL nuk ka kundërshtuar. Po ashtu, komuna në kuadër të saj ka edhe Zyrën Komunale për Kthim dhe Komunitet (ZKKK) e cila përkujdeset kryesisht për çështjet dhe të drejtat e komuniteteve jo-shumicë.

Komuna e Kamenicës ka 11 drejtori të cilat udhëhiqen nga koalicioni PDK, AKR dhe AAK dhe është e organizuar në drejtori, si në vijim: (1) *Administrata e Përgjithshme (AKR)*, (2) *Drejtoria e Arsimit (PDK)*, (3) *Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa (PDK)*, (4) *Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor (AAK)*, (5), *Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi (AAK)*, (6) *Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (AKR)*, (7) *Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektoratit (AAK)*, (8) *Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (PDK)*, (9) *Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (AKR)*, (10) *Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (AAK)* dhe (11) *Drejtoria e Ekonomisë, Zhvillimit dhe Diasporës*

RRETH ORGANIZATËS JOQEVERITARE - RRJETI I LËVIZJES PAQËSORE

Organizata Rrjeti i Lëvizjes Paqësore është regjistruar zyrtarisht si OJQ lokale në 5 Mars të vitit 2004, por ka filluar të funksionojë më herët që nga 2001. Kjo ishte ndër organizatat e para që u bë aktive dhe anëtarët e saj morën pjesë pothuajse në të gjitha programet që kishin të bëjnë me temat lidhur mbi paqen dhe me dialogun në zonat e Kosovës dhe jashtë saj. Pas aktiviteteve rinore, NOPM ka arritur të zgjerojë angazhimin e saj dhe me kalimin e viteve ka rritur profesionalizëm në implementimin e projekteve të një spektri të gjerë, duke e dëshmuar veten si pjesëmarrës aktiv të shoqërisë civile në Kosovë. Përgjatë viteve të fundit, OJQ "NOPM" ka zhvilluar partneritete të shumta me një spektër të gjerë të organizatave lokale dhe ndërkombëtare, komunave dhe faktorëve tjerë aktivë në Kosovë: Ambasada e SHBA-ve në Kosovë, Komisioni Evropian, USAID, KFOS, ATRC, KCSF dhe OSCE etj. Tash mbi dhjetë vjet të aktivitetit, organizata është pjesë e partneriteteve, rrjeteve lokale dhe rajonale të shoqërisë civile, dhe pjesëmarrës i fushatave të ndryshme që kanë forcuar rolin e shoqërisë civile dhe zërin e qytetarëve karshi institucioneve. OJQ NOPM kryesisht ka për qëllim promovimin e demokracisë lokale dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në Kosovë, me fokusim në regjionin e Gjilanit e më theks të veçantë në komunën e Kamenicës, Novo Berdës dhe Ranilugut. Në përpjekjet e vazhdueshme për të zbatuar praktika demokratike jep rol të veçantë promovimit të

qeverisjes së mirë, përgjegjësive, transparencës dhe pjesëmarrjes në sferat e ndryshme të shoqërisë civile. Organizata NOPM në mbështetje të programit të USAID-it “Kosovo Advancing Together/Te Avancojmë Kosovën se Bashku është duke realizuar një projekt “Përmirësimin e kapaciteteve të Komiteteve për Komunitet dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim për nevojat e komuniteteve jo-shumicë në komunat e Novo Berdës, Ranilugut, Parteshit dhe Klokotit që ka për qëllim që këto komitete dhe zyra të përgjigjen dhe avokojnë për nevojat e komuniteteve jo-shumicë si dhe të përmirësojnë rritjen e pjesëmarrjes së pakicave në aktivitetet e qeverisjes vendore, aftësisë komunale për të vendosur prioritetet e zhvillimit nëpërmjet zhvillimit të planeve të punës duke marrë parasysh nevojat e komunitetit jo-shumicë, dhe fuqizimin e stafit komunal për të kryer më mirë, si dhe përfshirjen e Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim në ndikimin e vendim-marrjes lokale në lidhje me zgjedhjen e politikave dhe programit të synuar. Stafi i NOPM-se është duke u rritur, duke mundur kështu edhe rritjen e zonave të monitorimit në më shumë komuna të Kosovës dhe duke zgjeruar programet e veprimit. Synimi jonë është që të jemi pjesë e rrjeteve rajonale dhe prandaj ne do të vazhdojmë të përmbushim këtë qëllim, gjithmonë duke ruajtur raportet e mira me partnerët aktual. Avokimi dhe fushatat sensibilizuese në fushën e politikave publike siç janë, rritja e performancës së legjislativit dhe ekzekutivit, pjesëmarrjes së publikut në vendim-marrje dhe përmirësimin të qeverisjes lokale përbëjnë spektrin më të suksesshëm të punës së organizatës. Ne synojmë të mbetemi një partner konstruktiv në të gjitha proceset në kuadër të fushës sonë të veprimtarisë.

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA

Në këtë drejtim Komuna e Kamenicës mbetet e hapur për bashkëpunim më qytetarë dhe OJQ-të. Ky është një përfundim nga monitoruesit e organizatës OJQ NOPM por që është evidentuar edhe nga raportimet e mediave të shkruara dhe atyre vizuale lokale. Ka pasur disa raste përmes të cilave komuna ka dëshmuar respektimin e transparencës dhe qeverisjes së mirë, duke përfshirë hapjen e kryetarit ndaj organizatës NOPM si dhe organizatave tjera aktive në komunë, shqyrtimin me kohë dhe pa vonesa të kërkesave për qasje në dokumente zyrtare, informimin e qytetarëve mbi investimet kapital duke organizuar takime publike me qytetarë (tetë takime të organizuara gjatë periudhës së raportimit) etj. Kryetari ka iniciuar ndryshimin e rregullores komunale për transparencë sipas Udhëzimit Administrativë 005/2013 për Transparencë në Komuna i

lëshuar nga Ministra e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe ka formuar grupin punues i cili ka përpiluar planin e punës për rregulloren mbi transparencën. Në kuadër të llogaridhënies, deri në ditën e përpilimit të këtij raporti, kryetari i komunës në pajtueshmëri me ligjin ka prezantuar në kuvendin komunal në mënyrë periodike katër raporte financiare (një të tre-mujorit të fundit për vitin 2013 dhe tre të tre-mujoreve financiar¹ për 2014). Po ashtu përparësi e komunës është se ka themeluar katër komitete konsultative me qëllim të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje edhe pjesëmarrjen e tyre në konsultimet publike. Një prej dobësive të ekzekutivit të Komunës së Kamenicës është mungesa e organizimit të konsultimit publik për ndryshim të rregullores komunale mbi dhënien e pronës. Pastaj, komunikimi me qytetarët ende zhvillohet kryesisht qytetarët me kryetarin dhe shumë rrallë ndodh që të ketë diskutime të drejtorëve të drejtorive me qytetarë sepse ende po përcillet fenomeni se “vetëm kryetari mund të zgjidhe çështjet” edhe pse shumë çështje komunale mund të adresohen nga drejtorët e drejtorive.

RESPEKTIMI I PARIMEVE TË TRANSPARENCËS DHE QEVERISJES SË MIRË

Transparenca dhe llogaridhënia janë parimet themelore të cilat sigurojnë se institucionet publike përmbushin obligimet e tyre në kuadër të rregullave të parapara. Respektimi i këtij parimi është kërkesë fundamentale dhe shërben si njësi matëse për nivelin e demokracisë, progresin e arritur dhe si parakusht për integritet. Funksionimi i tyre shprehet në dy anë , në njërin anë institucionet duhet të informojnë publikun dhe të japin informata lidhur me punën e tyre, dhe në anën tjetër të argumentojnë rëndësinë, nevojën dhe ndikimin e vendimeve të tyre. Në këtë mënyrë krijohet një sistem përmes të cilit qytetarët ndikojnë në ngritjen e kontrollit e cila rezulton në profesionalizëm të shtuar dhe përgjegjësi nga institucionet. Në këtë drejtim Komuna e Kamenicës mbetet e hapur për bashkëpunim më qytetarë dhe OJQ-të. Ky është një përfundim nga monitoruesit e organizatës NOPM por që është evidentuar edhe nga raportimet e mediave të shkruara dhe atyre vizuale lokale. Si pjese e transparencës, komuna ka ndryshuar rregulloren komunale për transparencë sipas legjislacionit në fuqi. Po ashtu, komuna ka ndarë grante për OJQ-te lokale përmes thirrjes për projekt propozime por këtu komuna ka dështuar të monitoroj zbatimin e aktiviteteve të OJQ-ve që kanë përfituar nga grantdhënia. Në kuadër të kësaj komuna ka formuar një komision për monitorimin e zbatimit të projekteve pasi disa projekte kanë përfunduar aktivitetet

¹ Tetor- Dhjetor 2013 dhe Janar- Mars, Prill-Qershor dhe Korrik- Shtator 2014

e tyre para formimit te komisionit. Po ashtu, ekzekutivi ka propozuar kuvendit aprovimin edhe të dy kërkesave për grante për OJQ-te përkundër se njëra OJQ ka dështuar te ofroj dokumentacionin e kërkuar gjatë thirrjes për projekt propozime kurse tjetra ka qenë përfituese e grantit nga thirrja për grante. Gjatë kësaj periudhe 10 mujore të monitorimit të komunës së Kamenicës, NOPM ka hasur në praktika të qeverisjes së mirë ku kryetari ka organizuar tetë takime në terren më qytetarë për çështje kryesisht të ndërlidhura me infrastrukturën rrugore, kanalizime, ujësjellësve dhe ndriçime publike. Po ashtu gjatë planifikimi te buxhetit komunal, komuna ka organizuar tri dëgjime publike ku ka konsultuar qytetarët për propozimet e tyre por jo të gjitha këto sugjerimeve janë përfshirë në listën e projekteve prioritete për investimet kapitale.

QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE


E drejta për Qasje në Dokumente Publike është e drejtë themelore, e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe paraqet një prej parakushteve kryesore për transparencën në qeverisje. Sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike secili person fizik apo juridik i përhershëm ose secili person fizik apo juridik që i plotëson kushtet për regjistrim si banor i përhershëm i Kosovës, ka të drejtën e qasjes në dokumente publike, në varësi të parimeve, kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara. Qasja në dokumente zyrtare të komunës gjatë periudhës se raportimit ka qenë e papenguar dhe e hapur. Gjate kësaj periudhe, kërkesat për qasje ne dokumente zyrtare për qytetarët janë ofruar plotësisht dhe se nuk ka pasur asnjë rast të refuzimit nga komuna si dhe koha e shqyrtimi dhe ofrimit te përgjigjes ka qenë në kuadër të afateve ligjore. 20 kërkesa për qasje në dokumente zyrtare janë regjistruar dhe shqyrtuar pozitivisht dhe asnjë nuk është refuzuar. Kërkesat janë bërë kryesisht nga OJQ-te dhe qytetarët lidhur me shpenzimet të buxhetit, kontratave dhe konkurseve për punësim sidomos në shkolla dhe shëndetësi. Me këto veprime kryetari Sinani *po i përmbush premtimet dhe zotimet e tij për respektim të ligjit, më shumë transparencë, bashkëpunim më shoqërinë civile dhe trajtim të barabartë, respektim të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, Rregullores Komunale për Transparencë si dhe udhëzimeve administrative të tjera të cilat garantojnë qasje në dokumente publike.* Secili institucion publik është i obliguar të caktoj njësinë apo zyrtarin i cili është përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike i cili duhet të mbajë evidencë të saktë për numrin e kërkesave për qasje në dokumente publike si dhe numrin e lejuar apo të refuzuar të këtyre

kërkesave. Lidhur me këtë komuna ka të caktuar shefin e zyrës së informimit si Zyrtar dhe njësitin/ Zyrën Komunale për Shërbime për Qytetare për komunikim të drejtpërdrejt me qytetarët sa i përket qasjes në dokument zyrtare.

PERFORMANCA BUXHETORE E KOMUNËS SË KAMENICËS

Buxheti i përgjithshëm i komunës së Kamenicës për periudhën Janar-Shtator 2014 ka arrit që të shpenzohet në masën 96.23 % ose 6,984,290.30 € nga buxheti i alokuar prej 7,257,486.00€ ose 87.26 % nga buxheti i përgjithshëm i komunës për vitin 2014, që është 8,003,988.00 €. Kjo shifër është shifra më e mirë që është arritur ndonjëherë në shpenzimin e buxhetit në këtë komunë. Mirëpo, pjesa më e madhe pritet të shpenzohen në tre mujorin e fundit të 2014. Po ashtu e kemi një performancë të mirë edhe në inkasimin e të hyrave vetanake të komunës ku për periudhën Janar-Shtator 2014 ka arritur që nga planifikimi i të hyrave për vitin 2014 prej 1,166,927.00 € ti realizojë në masën prej 98.36 % ose në vlerën prej 1,147,765.97 €.


PARAQITJA GRAFIKE E BUXHETIT JANAR-NËNTOR 2014



SHPENZIMET SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE

KODI	PËRSHKRIMI	2,013	2,014	Progresi
13133	Shpenz.tjera udhet zyrt brenda vendit	10,535.50	14,989.16	142.27
13140	Shpenzimet e udhetimit jashte vendit	9,674.12	3,786.80	39.14
13141	Meditjet e udhetimit zyrtar jashte vendit	7,567.00	3,719.00	49.15
13320	shpenzimet tjera telef vala 900	16,086.68	2,640.03	16.41
13780	Karburant per vetura	67,245.59	54,784.67	81.47
14310	Dreka zyrtare	26,864.40	15,334.50	57.08

PARAQITJA GRAFIKE E BUXHETIT 2014 SIPAS KODEVE EKONOMIKE



Sfidë për planifikimin e buxhetit komunal mbetet performanca e dobëte e drejtorëve në planifikimin e buxhetit të tyre si dhe për investime kapitale. Gjate monitorimit, monitorët kane vërejtur se shumica e drejtove janë vonuar në përgatitjen e qarkoreve buxhetore (1, 2 dhe 3) duke i mos i ofruar me kohë format zyrtarit kryesor financiar dhe kështu duke vendosur komisionin komunal për përgatitjen e buxhetit në pozicion të pavolitshëm dhe e cila ka reflektuar në vonesa të zyrtarit të larte financiar për të dorëzuar qarkoret buxhetore.

PËRFSHIRJA E QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE DHE KONSULTIMET PUBLIKE

Konsultimet me publikun përbëjnë një mjet bashkëkohor për qeverisje të mirë dhe politikë-bërje që përdoret në të gjitha nivelet e administratës, përfshirë pushtetin lokal. Me anë të konsultimeve me publikun sigurohet që banorëve tu ofrohet mundësia që ti shprehin mendimet e tyre, që pritjet e tyre të dëgjohen dhe që në rrethana ideale të merren në konsideratë. Komunikimi i Komunës me qytetarë është në nivel të mirë. Por ky komunikim duhet të behet dy kahor ku komuna vetëm përcjellë informacione të qytetarët dhe qytetarët të kenë më shumë mundësi të përcjellin pastaj informata te komuna. Gjatë kësaj periudhe të monitorimit të komunës, OJQ NOPM ka hasur në pesë raste të praktikave të mira ku komuna ka konsultuar qytetarët ose ka përfshirë sugjerimet e tyre në projektet e bëra. Praktikrat demokratike të cilat synohen të arrihen përmes qeverisjes lokale, kërkojnë një komunikim të nivelit të lartë mes komunës dhe qytetarëve. Në këtë drejtim komuna deri me tani ka arritur të krijoj mekanizma komunikimi me qytetarët dhe të rrisë nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje në mënyrë të konsiderueshëm. Përkundër këtyre zhvillimeve pozitive në përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe konsultimet publike, ende mbetet sfida pjesëmarrja e lartë e zyrtarëve komunal në këto takime e që konsiderohen se janë kryesisht për qytetarë.

INSTRUMENTET E DEMOKRACISË SË DREJTPËRDREJTË

Ligji për vetëqeverisje lokale kapitulli i dhjetë (10) parasheh format e demokracisë së drejtpërdrejtë dhe format e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje në nivelin lokal. Kështu njihen: informimi *publik dhe konsultimi*, *e drejta e peticionit*, *iniciativa qytetare*, *referendumi*, *largimi i kryetarit dhe komitetet konsultative*. Realizimi i këtyre instrumenteve ka qenë në nivel të kënaqshëm gjatë vitit 2014. Pjesa më e madhe e këtyre instrumenteve janë realizuar gjatë vitit 2014, komitetet konsultative mbesin funksionale, përderisa diskutimet publike janë realizuar me një numër të konsiderueshëm të pjesëmarrjes së qytetarëve. Vlen të përmendet se në dy takimet publike, komuna ka arritur të tërheq interesimin për pjesëmarrje të një numër mjaftë të madh të qytetarëve, ku në takimin e parë kanë marrë pjesë rreth 80 qytetarë kurse në takimin e dytë rreth 150 qytetarë.

KOMITETET KONSULTATIVE

Komitetet konsultative paraqesin një prej mekanizmave kryesor të demokracisë së drejtpërdrejtë në nivelin lokal. Ato organizohen në sektorë të caktuar dhe përbehen nga qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile. Këto janë trupa në të cilët qytetarët dhe shoqëria civile përfshihen aktivisht në monitorim të punës së komunës dhe në propozime për aktivitetet e komunës. Komitetet konsultative mund të dorëzojnë propozime, bëjnë hulumtime dhe ofrojnë mendime për iniciativat e kuvendit të komunës, në pajtim me statutin e komunës. Komuna e Kamenicës i ka të themeluara katër (4) komitete konsultative: 1) *Komiteti për Planifikim, Zhvillim Lokal Ekonomik dhe Ambient*, 2) *Komiteti për Arsim, Kulture, Rini dhe Sport* 3) *Komiteti për Shëndetësi, Emergjenca dhe Çështje sociale* dhe 4) *Komiteti për Përfshirjen e Qytetarëve në Vendim-Marrje ne nivel lokal*. Këto komitete janë të themeluara gjate muajve Nëntor dhe Dhjetor dhe kanë qenë aktive dhe plotësisht funksionale. Deri me tani këto komitete kanë mbajtur nga një takim ku kanë zgjedhur kryesuesit dhe nën-kryesuesit e tyre dhe tri prej tyre kanë hartuar planet e punës.

MARRËDHËNIET E KRYETARIT ME ASAMBLENË KOMUNALE

Në Kartën e Evropiane thuhet se e drejta për Vetëqeverisje Lokale, më qëllim të rregullimit dhe menaxhimit të një pjese të konsiderueshme të çështjeve publike në të mirë të qytetarëve “duhet të ushtrohet nga kuvendet të cilat nën mbikëqyrje mund të kenë organe ekzekutive që u raportojnë atyre”². Sipas ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kuvendi i komunës ka kompetenca të qarta në miratimin e statusit, planeve investuese, buxhetin e komunës, planet vjetore te punës dhe pune tjera që përcaktojnë punën e komunës respektivisht të Kryetarit. Kjo nënkupton se kryetari i komunës duhet ti përgjigjet dhe ti raportoj kuvendit për të gjitha veprimet që ndermirën nga ekzekutivi në qeverisjen e komunës. Bazuar në të dhënat e monitoruesve Kryetari ka marrë pjesë në te gjitha (10) punimet e asamblesë gjatë periudhës se raportimit 10 mujor. Përveç prezencës se tij te vazhdueshme dhe te rregullte në seancat e kuvendit, monitorët kanë vërejtur prezencën e jo të rregullte dhe me mungesa te shpeshta të drejtorëve te drejtorive, me theks drejtorin e drejtorisë se ekonomisë, zhvillimit dhe diasporës. Prezenca e kryetarit në Kuvend i ka ofruar një qasje të papenguar dhe te komunikimi te drejtpërdrejtë te anëtarëve te kuvendit komunal që të adresojnë pyetjet dhe çështje të

² Karta Evropiane mbi Vetëqeverisjen Lokale, neni 3.2

ndryshme atij si dhe drejtorive dhe kështu te rrisin efikasitetin dhe performancën e punës se ekzekutivit. OJQ NOPM ndihet e kënaqur lidhur me raportet dhe materialet të cilat i paraqiten kuvendit nga ana e Kryetarit si dhe afërsinë me të gjitha subjektet politike të përfaqësuar ne kuvend. Në përgjithësi këto raporte, të punës dhe ato financiare janë përmbledhje e të dhënave në forma tabelore dhe paragrafëve përshkrues të cilat tregojnë ne mënyrë te qartë problemet dhe sfidat të cilat i ka hasur ekzekutivi. Gjithashtu kërkesat dhe pyetjet e këshilltarëve kundrejt kryetarit marrin pothuajse gjithherë përgjigje te menjëhershme nga ana e tij.

PERFORMANCE E DREJTORIVE KOMUNALE

Gjatë periudhës 10 mujore te monitorimit, monitorët e OJQ-se kanë pasur takime të rregullta mujore me drejtorët e drejtorive komunale si dhe me stafin e drejtorive. Te gjithë drejtorët kanë qenë mjaftë korrekt, bashkëpunues dhe të gatshëm të ofrojnë informata te cilat monitorët tanë kanë kërkuar gjatë takimeve. Pyetësorët tanë kanë qenë te përpiluar prej pyetjeve si në vijim 1) Sa kërkesa janë pranuar ne drejtori gjatë një muaji? 2)Sa janë shqyrtuar pozitivisht apo refuzuar? 3) Sa vendime kanë marr drejtoria për çështje te caktuara? 4) A ka iniciuar drejtoria ndryshimin e ndonjë rregullores komunale? 5) A mbajnë takime të rregullta drejtoria me stafin e vet? 6) A konsultohen punëtorët me drejtorin dhe drejtori me kryetarin para marrjes së vendimeve? 7) A takohet drejtori, stafi me qytetarët dhe nëse po, çka diskutohet? 8) A shqyrtohen kërkesat e qytetarëve sipas ligjeve në fuqi dhe a njoftohen me kohë për vendimet? dhe 9) Të ndryshme. Sa përket kërkesave te pranuar në drejtori gjatë kohës se monitorimit³ janë pranuar gjithsej 31,752 kur prej tyre janë shqyrtuar 30,136 dhe disa që kanë qenë në procedurë të shqyrtimit, konkretisht 1,424 prej tyre. Lidhur me vendimet e marruara nga drejtoritë në baze të dhënave të ofruar nga vete drejtorët janë shënuar vetëm 5,238 vendime për çështje te caktuara si ne vijim p.sh, vendime për taksa komunale, leje të taksive, subvencione, ndihme sociale, prerje te drunjëve, shfrytëzimi i hapësirës publike, garazhe dhe kioska etj. Shumica e drejtorive lidhur me vendosjen për shqyrtim pozitiv ose negativ të kërkesave vendosin me vendime, ndërsa ka edhe prej atyre drejtorive që për çështje të caktuara vendosin me anë të certifikatave, lejeve, vërtetimeve dhe akteve të tjera. Edhe pse te gjithë drejtorët kanë theksuar se mbajnë takime me stafin e tyre, por gjatë takimeve dhe diskutimeve ka rezultuar se ata nuk mbajnë mbledhje te rregullta me personelin e tyre ne mënyrë te

³ Prill- Nëntor

rregullt por vetëm në baza ad hoc ose kur ndonjë çështje urgjent kërkon për atë. Një zhvillim mjaftë pozitive është vërejtur tek disa drejtoritë komunale që qenë mjaft aktive në inicimin dhe ndryshimin e rregulloreve komunale ku nga 11 drejtoritë, 6 prej tyre kane iniciuar ndryshimin e rregulloreve si në vijim:

- ✓ Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari ka iniciuar rregulloren për korrije-shirje (Qershor)
- ✓ Drejtoria për Ekonomi Zhvillim dhe Diasporë ka iniciuar rregulloren mbi ndryshimin e tarifave (Maj)
- ✓ Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka iniciuar një plan për vlerësim të rrezikut (Nëntor)
- ✓ Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër ka iniciuar dy rregullore njëra ka qenë Rregullore për ngastra dhe tarifa(Prill) dhe tjetra për Programin e banimit trevjeçar (Qershor)
- ✓ Drejtoria për Urbanizëm dhe Kadastër ka iniciuar rregulloren për taksa dhe tarifa(Prill)
- ✓ Drejtoria për Shërbime Publike ka iniciuar ndryshimin e rregullores për taksa dhe tarifa

Gjatë takimeve të rregullta me drejtorët e drejtorive si dhe shërbyesit civil është vërejtur se komunikimi është i mirë ndërmjet tyre dhe kryetarit. Po ashtu ata gjithmonë konsultohen mes veti dhe në shume raste para marrjes së vendimit konsultohen edhe me kryetarin, por prapë ka ende hapësirë për përmirësime të metodave të komunikimit dhe konsultimit. Një e metë vërehet se detyrat në masë të madhe ende merren dhe raportohen gojarisht ose përmes telefonave dhe shumë pak përdoret komunikimi elektronik ndërmjet tyre. Sa i përket takimeve me qytetarë, ata kanë takime të rregullta me qytetarë dhe temat e diskutimeve ndryshojnë varësisht nga nevojat e qytetarëve dhe për çështje që i preokupojnë ata ku më të theksuarat janë: infrastruktura rrugore, rrjeti i ujësjellësit, ujerat e zeza, deponit ilegale, papunësia, tatimi në pronë, asistencë sociale, çështjet pronësore, lejet ndërtimore, pagesat e faturave, arsimit, shëndetësia, zhvillimet kulturore dhe sportive etj. Vërejtjet dhe kërkesat nga ana e drejtorëve të drejtorive komunale kanë qenë mungesa e automjeteve në këto drejtori të cilëve shpesh u pamundësohet dalja në teren dhe komunikimi i drejtpërdrejt me qytetarët të cilët banojnë në pjesët rurale. Dhe për fund, të gjitha vendimet shqyrtohen sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi dhe se qytetarët rregullisht njoftohen me kohë për kërkesat e tyre, duke respektuar afatin ligjor.

REKOMANDIMET

- Te publikohen në faqën zyrtare të komunës aktet e miratuar nga organet e komunës duke përfshirë zyrën e kryetarit dhe drejtorive komunale;
- Te organizohen takime mes drejtorëve me stafin e tyre ;
- Krijimi i një strategjie për bashkëpunim me shoqërinë civile;
- Zgjidhja e çështjes se taksistëve të cilët nuk lejohen të marrin udhëtarë në Gjilan
- Rregullohet çështja e pronësisë së banesës së “Kranit”
- Inicimi dhe ndryshimi i rregulloreve komunale që për bazë dhe reference ligjore kanë ende Rregulloren e UNMIK-ut (2007/30);
- Koordinimin e aktiviteteve me nivelin qendror për gjetjen e zgjidhjes për çështjen e qenve endacak ;
- Komunikim më kualitativ në mes komunës dhe shoqërisë civile;
- Organizimi më i shpeshtë i takimeve publike me qytetarë veçanërisht në fazën e përpilimit të projekteve kapitale dhe planifikimit të buxhetit komunal;
- Marrja parasysh e propozimeve të qytetarëve për investime kapitale sipas mundësive buxhetore;
- Të regjistrohen dhe të publikohen në faqen zyrtare të komunës pronat e paluajtshme të komunës që janë të dedikuara për dhënien në shfrytëzim;
- Ngritja e nivelit të pjesëmarrjes qytetare në procesin e vendimmarrjes
- Në fillim të vitit të paraqitet në Kuvendin Komunal, Plani Dinamik i realizimit të projekteve nga Lista e Investimeve Kapitale;
- Mbikëqyrje më efikase e realizimit të punëve në projektet kapitale, veçanërisht në projektet infrastrukturore;
- Mbrojtje më e mirë e pronës publike mbi baza ligjore;
- Përmirësimi i bazës të dhënave komunale mbi tatimin në pronë
- Shpenzimin efikas të fondeve publike- në projekte të zhvillimit ekonomik
- Krijimin e mekanizmave mbikëqyrës për zbatimin detaj të kontratave publike
- Ngritja e kapaciteteve të Kuvendit në hulumtime dhe njohuri profesionale në çështje të caktuara.
- Pjesëmarrje më aktive e gruas në çështjet të ndërlidhura me punën e ekzekutivit
- Pjesëmarrja më aktive e të rinjve në aktivitet komunale si dhe alokimi i fondeve për çështje të rinjve

***"Ky projekt u financua përmes Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për
Demokraci.***

***Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë
te Autorit (ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Ambasadës së Shteteve të
Bashkuara të Amerikës (SHBA)"***

